



RTK 1
Mentor SHALA
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2017/220
Ref:1712/1363/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2017/220 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për RTK 1 (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është transmetues publik me seli në Prishtinë. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet tjera përkatëse ligjore.
2. Në bazë të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, KPM është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave përmes të cilave përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
3. KPM duke u bazuar në kapitullin e VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje. Udhëzuesi i KPM-së me datën 10 nëntor 2017 i është dërguar Palës Përgjegjëse me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore gjatë Balotazhit në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
4. KPM ka bërë monitorimin e programit të Palës Përgjegjëse, gjatë fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore për zgjedhjet e Balotazhit, me qëllim të vlerësimit pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
5. Bazuar në raportin e monitorimit të datës 16 nëntor 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spote politike me pagesë të SPÇ-ve LDK dhe PDK, të cilat nuk i ka identifikuar se nga kush janë të sponsorizuara.
6. KPM, në bazë të të gjeturave të monitorimit, me datën 16 nëntor 2017 i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke i kërkuar të përgjigjet me shkrim menjëherë pas pranimit të Njoftimit.
7. KPM nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga RTK 1 pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje.

8. KPM ka bërë edhe një monitorim të Palës Përgjegjëse dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 18 nëntor 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për Shkelje ka vazhduar të transmetojë spote politike të pidentifikuara se nga kush janë të sponsorizuara.
9. Pala Përgjegjëse përgjatë mbulimit të fushatës zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme dhe raundit të parë të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017 është sanksionuar nga KPM-ja për shkak të shkeljes së rregullave të përcaktuara me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje (transmetim të spoteve politike më të gjatë se dy minuta, neni 49.1) dhe Kodit të Etikës KKPM-2016/03 (transmetimi i spoteve politike me prezencë të fëmijëve, neni 9).

Analiza Ligjore

10. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Balotazh të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës ka transmetuar spote politike të pidentifikuara se nga kush janë të sponsorizuara, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.”


11. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse edhe pas Vendimeve të Komisionit të KPM-së Ref:1708/785/KPM/am dhe Ref:1711/1273/KPM/am ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.
12. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.

Vendimi

13. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së sanksionon Palën Përgjegjëse me gjobë në vlerën prej 1.000 (njëmijë) euro për shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.

E drejta për Ankesë

14. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



05.12.2017
Datë